



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKAI KOSOVËS / RIKUTRITA KOSOVA - RIKUTRITA E KOSOVËS MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia.org Org.Jedica Org.Unit	50-02	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	2890-2/24
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-04-	Data Datum Date	04.04.25
PRISHTINË / A			No. 1

DATË/A:	13.03.2025
REFERENC-Ë:	24/2890/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, Shfrytëzim i gurit gëlqeror në Tarllabuq, Vushtri. Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e kërkesës për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore të operatorit "Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë me nr. prot.24/2890/MMPHI, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror në Tarllabuq, Vushtri.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. 24/2890/MMPHI
Datë: 13.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi, 1, 2 dhe 4 të nenit 12, neni 17, paragrafi 2 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, me nr.prot.24/2890/MMPHI, i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në ngastrat nr.P-70202065-00040-0, nr. P-70202065-00041-0, nr.P-70202065-00042-0, nr. P-70202065-00043-0, nr. P-70202065-00045-0 në sipërfaqe prej 8.24.61 ha apo 82.461m², zona kadastrale Tarllabuq,Vushtrri.



A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Gurëbardhi" Sh.p.k. Klinë, me nr. prot. 24/2890/MMPHI, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në në ngastrat nr.P-70202065-00040-0, nr. P-70202065-00041-0, nr.P-70202065-00042-0, nr. P-70202065-00043-0, nr. P-70202065-00045-0 në sipërfaqe prej 8.24.61 ha apo 82.461m², zona kadastrale Tarllabuq,Vushtrri, sipas Pëlqimit Mjedisor Nr.:16/5429/1-ZSP//17, të datës: 02.02.2017, MMPHI konstaton se operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 12, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr.04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqimit Mjedisor me Nr. 16/5429/1-ZSP//17, të datës: 02.02.2017;
- Leja Mjedisore me Nr.18/4074/ZSP/218/19, të datë:26.04.2019;
- Licencë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, Nr.Prot.1722/KPMM/2017; me afat gjerë me: 09.08.2025;
- Njoftim nga Komuna Vushtrisë 08.Nr.570/16, të datës:15.11.2016, ku potencohet prezenca e burimeve të ujit, me prurje 2 L/sec, me karakteristika të ujit të pastër, pa erë dhe shijo dhe temperaturë rreth 20°C.
- Pëlqim nga APK , ref.-KE-290/17, të datës: 26.05.2017.

Bazuar në dokumentin për Njoftim nga Komuna Vushtrisë 08.Nr.570/16, të datës: 15.11.2016, për ekzistencën e burimeve ujore, të cilët nuk janë paraqitur në Raportin e VNM-së, sipas Shtojces 4, të Ligjit Nr.08/L-181, të VNM, MMPHI gjatë shqyrtimit të lëndës, ka kërkuar nga operatori studim (elaborat) hidrogjeologjik rreth burimeve të ujit. Me këtë rastë janë verifikuar të dhënat nga elaborati dhe është gjetur që burimi i ujit është prezantuar në hartë hidrogjeologjike që ekziston, por pa koordinata, dhe nuk paraqet lëvizjen e ujit në aquifer (drejtimi i ujit) me fakte të argumentuara. Burimi i ujit është prezantuar në hartën hidrogjeologjike, me të vetmen të dhënë numerike, për lartësinë mbidetare që përputhet me pozicionet e eksplotuesit të gurit gëlqeror.

Andaj duke u bazuar në faktet e nxjerra nga të dhënat e analizuara, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori nuk i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr **Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore.**



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D.i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës Vushtri;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së